## STATUTI I SHOQËRISË METROPOL SECURITY SHPK

( I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR )

Bazuar ne Ligjit per Tregtaret Nr. 9901, datë 14.04.2008 dhe aktet e tjera Nenligjore.

**Neni 1 – Emri dhe Forma Juridike**

Shoqëria quhet **Metropol Security Shpk** dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.), në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

**Neni 2 – Selia e Shoqërisë**
Selia është në:
Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga Haxhi Dalliu, Pallati "Alva Konstruktion", Kati 1, Ap. A/5, Tiranë, Shqipëri.
Shoqëria mund të hapë filiale apo njësi të tjera në çdo qytet ose jashtë vendit.

**Neni 3 – Kohëzgjatja**

Shoqëria themelohet me kohezgjatje ( 15 vjet ) ,duke filluar nga data e rregjistrimit te shoqerise ne rregjistrin tregtare me perjashtim te rastit te mbarimit te saj sipas kushteve te parashikuara me ligj.

**Neni 4 – Objekti i Veprimtarisë**

**Objekti i Veprimtarisë** Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin në fushat:

1. **Shërbime sigurie fizike (SHPSF):** Ruajtja, mbrojtja, survejimi dhe shoqërimi i personave fizikë dhe juridikë, objekteve publike dhe private, të shtetasve shqiptarë dhe të huaj; ofrimi i shërbimeve të rojeve civile të klasit A dhe B sipas , Ligji 75/2014 Dt : 10.07 .2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" Kreu III –Neni 18 Pika 1 . Udhezimi Ministrit te Brendeshem Nr .130 Dt : 05.03.2018 "Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike. IndRyshuar me ligjin nr .90/2023 dates 02.11.2023 Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe udhezimin nr 154 date 16.08.2024 " Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike .

2. Ligjit Nr. 19/2016 "Për masat Shtesë të Sigurisë Publike". Udhezimi Ministrit te Brendeshem Nr. 134, datë 10.3.2017 . . Ligjit Nr.152/2015 , Mbrojtjes Ndaj Zjarrit ,Udhezimi Nr .81 Date 06.03.2020 . etj

Edita Korçari

Edita

3. **Sisteme sigurie dhe teknologji informacioni (TIK):** Projektim, montim, instalim, mirembajtje dhe tregtim i sistemeve të vëzhgimit, sinjalizimit, GPS/GSM, CCTV, akses kontrolli, serverë, rrjete informatike dhe të dhënash elektronik.

4. **Prodhimi dhe tregtimi i energjisë nga burime të rinovueshme:** Projektim, ndërtim, operim dhe mirëmbajtje të impianteve të prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme (fotovoltaik, eolik, ujor, biomasa), si dhe tregtim dhe shitje e energjisë elektrike, në përputhje me Ligjin Nr. 7/2017 dhe Ligjin Nr. 43/2015.

5. **Infrastrukturë dhe ndërtime:** Projektim, ndërtim dhe supervizim rrugësh, impiantesh të ujit dhe energjisë, punime elektromekanike në hidrocentrale, termocentrale, aeroporte e autostrada.

6. **Shërbime mbështetëse dhe konsulencë teknike:** Pastrim ambientesh, sistem audio/video, sinjalistikë, kontroll elektronik radhësh, zbatim dhe këshillim Konsulence në fushen e teknologjie dhe Robotikes,Aplikacioneve , elektrike dhe ndërtimore .instalim sistemeve Elektromjeksore ,mirembajtje etj ,

**Neni 5 – Kapitali Themeltar dhe Kuotat.**

Kapitali themeltar është 100,000 lekë, i ndarë në 1 kuotë prej 100%.
Kapitali është i paguar tërësisht nga themeluesja **Edita Korçari**, me ID- K46216052C.

**Neni 6 – Ortaku i Vetëm**

Ortaku i vetëm është: **Edita Korçari**, e datëlindjes 16.12.2004, banuese në Tiranë .

**Neni 7 – Organet Drejtuese**

Organet janë:

1. **Kuvendi i Ortakëve** – përbëhet nga ortaku i vetëm.
2. **Administratori** – është i emëruar nga ortaku i vetëm, me afat 4 ( kater ) vite e cila eshte nje nga ortaket e shoqerise

Administratori është **Edita Korçari**, me me afat 4 ( kater ) vite të caktuar, dhe ka të drejtën e përfaqësimit të plotë të shoqërisë në çdo veprim ligjor dhe ekonomik.

**Neni 8 – Kompetencat e Administratorit**

Edita Korçari

Edita

**Administratori:**

- Përfaqëson shoqërinë në çdo institucion, bankë apo gjykatë;
- Ka të drejtë të lidhë kontrata, të hapë dhe mbyllë llogari bankare;
- Emëron dhe shkarkon punonjësit;
- Caktim likujdatoreve
- Miratim Bilancit

**Neni 9 – Vendimmarrja dhe Mbledhjet**

**Ortaku i** vetëm merr vendime me shkrim për:

- Ndryshim statuti;
- Emërim/shkarkim administratori;
- Shpërndarje fitimi ose mbulim humbjesh;
- Likuidim apo ristrukturim të shoqërisë.
- Zvogelim kapitalit /rritje te kapitalit
- Ka të drejtë të caktojë përfaqësues të përkohshëm me prokurë të posaçme.

Vendimet regjistrohen në një regjistër të veçantë vendimesh dhe mbahen për kontroll ligjor.

**Neni 10 – Fitimet dhe Rezervat**

Fitimet shpërndahen 100% tek ortaku i vetëm, pas përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe krijimit të fondit rezervë në masën 5% të fitimit neto çdo vit, derisa të arrijë 1/10 e kapitalit.

**Neni 11 – Transferimi i Kuotave**

Ortaku i vetëm mund t'ia kalojë kuotat e tij personave të tjerë me akt noterial. Në rast të kalimit të kuotave, shoqëria nuk shndërrohet automatikisht në shoqëri me shumë ortakë, përveçse nëse ortaku i ri e kërkon dhe e regjistron këtë ndryshim në QKB.

**Neni 12 – Kontrolli dhe Kontabiliteti**

Shoqëria është e detyruar të mbajë llogari sipas standardeve shqiptare të kontabilitetit dhe të dorëzojë bilancin vjetor pranë DPT-së dhe QKB-së.qe perkon me vitin kalendarikditen e pare te janarit , dhe mbaron diten e tridhjeteenji  Kontrolli mund të bëhet nga vetë ortaku ose kontabilist i autorizuar.librat kontabel do te administrohen ne gjuhen shqipe ,

Shoqeria mund te marre financim nga istitucione brenda dhe jashte vendit ,shoqeria mund te vendos kapitalin e saj si garanci me vendim te ortakut te vetem .

Edita Korgari

Edita

**Neni 13 – Shkrirja dhe Likuidimi**

Shoqëria mund të shkrihet me vendim të ortakut të vetëm ose sipas rasteve të përcaktuara në ligj (insolvencë, skadim afati, vendim gjykate).
Likuidatori mund të jetë vetë administratori ose një person tjetër i emëruar nga ortaku.ose caktohet likujdator per procedurat ligjore .

Likujdatori perpilon gjendjen e shoqerise dhe ndjeke hapat ligjore ,ortaku i vetem ben miratimin perfundimtare ,

**Neni 14 – Dispozita Përfundimtare**

Për çdo çështje të pambuluar nga ky statut, zbatohen dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 dhe aktet e tjera përkatëse.

---

Dokumenti perpilohet 4 kopje orgjinale,

**Përpiluar në Tiranë, më datë 09.09.2025**

**Themeluesja / Ortaku i vetëm / Administratorja**
**Edita Korçari**

**Nënshkrimi:** Edita Korçari